

OK

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit

MP në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit”

Ofruar nga

Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Kozeta Sevrani



Dr. Gjergji Mulla



(Tetor/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MP në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit”

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti I Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit	Urdhër i MASR Nr 209, datë 27.04.2019 VBA Nr 11, datë 30.03.2018
4	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit”
5	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik/2 semestra
7	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli i 7 (shtatë)
15	Aktivizimi i programit të studimit	2018-2019
16	Numri i studentëve	10 studentë
	etj	

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit MP në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit”

SHLUJ UMB është institucion jopublik i arsimit të lartë, që është krijuar në bazë të "Ligjit Nr.9741, datë 21.5.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe në bazë të VKM Nr.571, datë 12.08.2005 "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare jopublike "Universiteti Marin Barleti". Ky Institucion funksionon në bazë të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe është i përfshirë në procesin e azhornimit të veprimtarisë së tij në përputhje me ndryshimet e parashikuara në Ligjin Nr.80/2015 dhe aktet nënligjore të dala në bazë të tij.

SHLUJ UMB ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2005 mbi bazën e VKM nr. 571. dt. 2.08.2005 "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare private Marin Barleti ", me dy Fakultete dhe pesë degë: Fakulteti i Gjuhëve të Huaja me degët gjuhë angleze, gjuhë gjermane dhe gjuhë frënge, dhe Fakulteti i Matematikës së Zbatuar me degët matematikë - administrim dhe matematikë - financë. Aktualisht Institucioni ka 2 Fakultete dhe konkretisht: Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe Politike si dhe Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë.

Programi i studimit Master Profesional në "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit" i është nënshtruar procedurës së vlerësimit paraprak të ASCAL në kuadër të licensimit dhe miratimi për hapjen e këtij programi është bërë me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr 11, datë 30.03.2018, me disa rekomandime. Programi është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 209, datë 27.04.2018. Sipas këtij Urdhëri, veprimtaria akdemike për këtë program studimi ka filluar në vitin akademik 2018-2019. Programi ofrohet me 60 ECTS; 1 vit akademik; 2 semestra; me kohë të plotë.

Programi është i organizuar në lëndë mësimore, të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Misioni i programit është të përgatisë profesionistë për të menaxhuar dhe realizuar funksionet teknike, fizike të një firme apo organizate, veçanërisht ato të lidhura me zhvillimin, prodhimin, marketingun.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof. Dr. Kozeta Sevrani

Dr. Gjergji Mulla

GVJ është asistuar gjatë gjithë procedurës nga specialistja e ASCAL, Znj. Suela Kromidha.

Më datë 27 Shtator 2019 nëpërmjet sistemit AMS është dërguar Draft RVJ në Institucion. Njoftimi për dërgimin e këtij Drafti është bërë edhe me shkresë zyrtare, më datë 30 shtator 2019.

Më datë 03 tetor 2019 nga Institucioni ka ardhur përgjigja/komente në lidhje me Draft RVJ. Kjo përgjigje ju dërgohet Ekspertëve të vlerësimit me email. GVJ i pa me kujdes këto komente dhe në lidhje me këto komente, GVJ jep shpjegim sa më poshtë:

Përgjigje e GVJ në lidhje me komentet e bëra nga Institucioni mbi Draft RVJ

1. Paraqitja në Draft RVJ: Programi i studimit MP në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit” synon për tu përshtatur me strategjinë e institucionit në drejtim të krijimit të profesionistëve (evidentuar kjo nëpërmjet vizitave në Institucion), por duhet të shihet mundësia e riformulimit të programit duke

zëvendësuar disa prej lëndëve të kësaj kurikule me lëndë më të përshtatshme për formimet profesionale në fushën e TI.

Nga ana e ekspertëve të GVJ u sugjerua që të rishihej mundësia e ofrimit të lëndëve të reja, të cilat do të ngrinin në një nivel më të lartë dhe do ta përshtatnin më mirë këtë PS me tregun e punës. GVJ mendon se moduli “Metoda Kërkimi Shkencor” mund të mos zhvillohet për shkak se masteri synon të jetë profesional dhe me numër të vogël kreditesh (60 të tilla). Në vend të tij psh., mund të zhvillohet një modul si “Infrastruktura e TI”, e cila jep një formim të përgjithshëm për infrastrukturën e kësaj teknologjie në nivel organizate, aq më tepër që këto njohuri mund të mos jenë marrë për studentët që vijnë nga profile ose formime jo informatike. Një modul tjetër mund të jetë “Seminar special” ose “Kurs Special”, i cili mund të synojë ofrimin e njohurive të reja në një drejtim të caktuar (psh për një lëndë gë del e nevojshme të shtohet, pa prishur planin mësimor), duke ftuar profesionistë ose CEO të organizatava apo bizneseve. Po ashtu, moduli “Sistemet e Informacionit në Organizata” trajton pjesërisht konceptet e nevojshme, ndaj duhet riparë sylabusi, i cili duhet të përditësohet me botimet e reja në këtë fushë si dhe shtimin e rasteve të studimit, gë e bën më konkret modulin.

Por orët laboratorike janë të pamjaftueshme në disa module, të cilat duhet të jenë më orientuara për lëndë specifike dhe të detajohen në sylabuset e tyre se çfarë trajtohen konkretisht

Përgjigja nga ShLUJ UMB: Ne jemi të hapur për ndryshime, veçanërisht meqë jemi në një fushë që ka zhvillim shumë të shpejtë. Psh. lënda Data Warehouse mund të zëvendësohet me lëndën Analizë të dhënash. Gjithashtu si politikë e Departamentit sylabuset përditësohen në fillim të çdo viti akademik pikërisht për shkak të zhvillimit dinamik të fushës. Por ky plan mësimor është liçencuar para një viti, me këtë strukturë dhe këtë shpërndarje të orëve laboratorike dhe me modulin për "Metodat e kërkimit shkencor". Siç u sqaruar edhe gjatë takimit me GVJ, kërkimi shkencor nuk është më luks vetmë i botës akademike por gjithnjë e më tepër zhvendoset edhe në botën e biznesit. P.sh sot vështirë të gjesh Universitet që t'i konkurojë Google apo Facebook në fushën e procesimit të gjuhëve natyrore. Përveç kësaj, Insitucioni ka edhe një kornizë të veten për të gjitha programet studimore. ku përfshihen orët mësimore dhe moduli "Metoda Kërkimi Shkencor". Departamenti do të marrë në konsideratë sugjerimet e ekspertëve dhe pas akreditimit do të bëjë përditësimet e nevojshme.

Përgjigja e GVJ: Programi i studimit MP në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit” synon për tu përshtatur me strategjinë e institucionit në drejtim të krijimit të profesionistëve, gjë që është evidentuar nëpërmjet vizitave në institucion. GVJ mendon se përmirësimi në të ardhmen me module të përditësuara ose dhe të ndryshuara në ndonjë modul do t'i jepte më shumë vlera këtij PS. Sidoqoftë, ne pajtohemi me politikat e institucionit për të bërë ndryshimet në të ardhmen, sipas dinamikave që detyron zhvillimet e TI. Përfshirja e lëndëve të propozuara prej nesh si ekspertë të fushës mund të çoj në një përmirësim të ndjeshëm por dhe të realizueshëm nga ana e stafit të ShLUJ UMB. Argumenti i institucionit se “Departamenti do të marrë në konsideratë sugjerimet e ekspertëve dhe pas akreditimit do të bëjë përditësimet e nevojshme”, pranohet.

Në lidhje më përgjigjen e IAL për licensimin e këtij programi para një viti akademik, GVJ mendon se argumenti pranohet në këto kushte, nëse pranojmë që plani mësimor është i miratuar vitin e kaluar dhe është paraqitur si i tillë. Sidoqoftë, plani duhet përmirësuar përsa i përket shpërndarjes së orëve laboratorike në lëndët që kanë më orientim praktik se teorik në të ardhmen.

GVJ merr pjesërisht në konsideratë përgjigjen e IAL dhe bën ndryshim të pjesshëm në Draft RVJ.

2. Paraqitja në Draft RVJ: Biblioteka e institucionit nuk ka libra të mjaftueshëm të lidhur me programin e studimit. Literaturën lidhur me këtë program studimi studentët mund ta aksesonin vetëm në

Bibliotekën online, e cila duhet të jetë më e përditësuar. Duhet riparë buxheti në lidhje me shtimin e zërave të rinj.

Përgjigja nga ShLUIJ UMB: Biblioteka po pasurohet me tituj të rinj në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja sipas një procedure të stabilizuar në UMB. Çdo fillim viti departamenti bën një planifikim për librat që i duhen dhe institucioni blen librat. Megjithatë në ndonjë rast tekstet në gjuhën shqipe nuk janë të përditësuar me ndryshimet më të fundit në fushën e TI.

Përgjigja e GVJ: se Biblioteka mbetet një problem që duhet rinovuar me tituj të rinj, tekste shkollor ose jo, revista, periodikë të fushës, etj. Mënyra e organizimit të bibliotekës të mendohet nga ana e institucionit, për të ofruar fizikisht apo në mënyrë dixhitale botimet e nevojshme për fushën.

GVJ nuk bën ndryshim në Draft RVJ.

3. Paraqitja në Draft RVJ: Nuk evidentohen marrëveshje bashkëpunimi të veçanta për këtë PS, me qëllim mbështetjen e aktiviteteve të ndryshme të procesit mësimor, duke përfshirë dhe praktikave profesionale. Konstatuam se duhet të shihet si prioritare mundësia e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private për kryerjen sidomos të këtyre praktikave profesionale për studentët e Masterit Profesional. Në kuadrin e këtij MP nuk vërehen marrëveshje të veçanta për këtë master, po për të gjitha PS-të e këtij institucioni. Ne sygjerojmë që në bashkëpunim me biznesin, studentët të mund të bëjnë një praktike më afër realitetit.

Përgjigja nga ShLUIJ UMB: Institucioni realizon marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme në funksion të programeve të studimit. Edhe departamenti ka marrëveshje të veçanta bashkëpunimi me bizneset, të cilat përdoren për zhvillimin e praktikave dhe bashkëpunimeve për aktivitete në të gjitha programet.

Përgjigja e GVJ: Duhet të shihet si prioritare nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private për kryerjen sidomos të këtyre praktikave profesionale për studentët e Masterit Profesional.

GVJ nuk bën ndryshim në Draft RVJ.

4. Paraqitja në Draft RVJ: Duhet të rritet efikasiteti i informacionit lidhur me PS. Institucioni duhet të publikojë në web-in e saj informacion për programet e studimit, aq më shumë për programet e reja, të cilat janë të panjohura për aplikantët.

Përgjigja nga ShLUIJ UMB: ShLUIJ UMB ka informacion të hollshëm në web në faqen zyrtare për programin e studimit. Të interesuarit mund të mësojnë rreth fokusit të programit, lëndëve që do të ndjekin, kohëzgjatjen e programit dhe mundësitë e punësimit. Të gjithë aplikantët që paraqiten në UMB marrin informacione edhe më të detajuara rreth silabuseve, frekuencimit, të drejtave dhe detyrimeve nga institucioni etj. ShLUIJ UMB ka publikuar broshurë informuese në lidhje me programin. Ju mund të shkarkoni broshurën dhe të gjeni informacion më të detajuar në faqen zyrtare të ShLUIJ UMB, në linkun <http://www.umb.edu.al/mp/mp-menaxhim-i-teknologjiss-se-informacionit.html>

Përgjigja e GVJ: Informacioni i vendosur në faqen e institucionit jep njohuritë e kërkuara. Prezenca e broshurës është një gjetje e mirë. Argumenti pranohet.

GVJ bën ndryshim në Draft RVJ duke e riformuluar fjalinë: Në lidhje me këtë program studimi, informacioni vendosur në faqen e web i jep njohuritë e kërkuara. Prezenca e broshurës është një gjetje e mirë. Informacioni në të është bazik dhe i mjaftueshëm.

5. Draft RVJ: Gjatë takimit me sekretarinë mësimore u vunë re që ishin dhënë provime nga studentët jashtë sezoneve, gjë që është në kundërshtim me strukturën mësimore të aprovuar. Kjo gjë u vu re nga datat e procesverbaleve që na u treguan nga ana e sekretarisë mësimore.

Përgjigje nga ShLUJ UMB: ShLUJ UMB zbaton me përpikmëri kërkesat për organizimin e procesit mësimor. Sa i takon gjykimin tuaj në lidhje me organizimin e provimeve ju shpjegojmë se shlyerja e moduleve bëhet me provim përfundimtar në përfundim të çdo moduli. Nuk bëhet fjalë për provime ekstra jashtë sezonit.

Përgjigja e GVJ: Nga kontrolli i procesverbaleve dhe intervista me studentët rezultonte se kishte kapërcim të afateve të provimeve. Duke qënë se kjo ishte një dukuri e rrallë, institucioni duhet të marrë masa.

GVJ nuk bën ndryshim në Draft RVJ.


6. Përgjigja e Draft RVJ: Duhet të kihet kujdes në pranimin e studentëve që nuk kanë formim TI për arsye se mund të mos jenë në gjendje të ndjekin këtë program për mungesë të njohurive mbi teknologjinë e informacionit. Gjithashtu për studentët që nuk kanë formim TI të vendosen disa kriteret bazike parakualifikuese. Tek Konkluzionet: Në këtë program janë rregjistruar edhe studentë me diplomë bachelor nga fakultete të tjera, dhe që nuk kanë formim IT.

Përgjigja nga ShLUJ UMB: Programi nuk është hartuar ekskluzivisht për studentët e fushës së IT. Në kriteret e pranimit pranohen edhe studentë nga profile të tjera. Kompetencat dhe aftësitë e secilit kandidat analizohen rast pas rasti dhe jepen leksione shtesë atëherë kur konsiderohet se ka nevojë. Megjithatë e theksojmë edhe një herë se ky program mund të ndiqet nga çdo i interesuar që ka interes ose përvojë profesionale në fushë.

Përgjigja e GVJ: Pranohet argumenti që mund të pranohen edhe studentë jashtë profilit të TI, por ata detyrimisht duhet t'i nënshtrohen parakushteve, pasi egziston rreziku i uljes së nivelit akademiko-profesional për të plotësuar mungesën e formimit të fushës.

GVJ bën ndryshim në Draft RVJ duke e riformuluar fjalinë: GVJ mendon, se duhet të kihet kujdes në pranimin e studentëve që nuk kanë formim IT për arsye se mund të mos jenë në gjendje të ndjekin këtë program për mungesë të njohurive mbi teknologjinë e informacionit. Gjithashtu për studentët që nuk kanë formim IT të vendosen disa kriteret bazike parakualifikuese. Për studentët që pranohen jashtë profilit të programit, GVJ ju komunikua se për këta studentët, në bazë të aftësive dhe kompetencave të gjithësecilit, mund të ofrohen leksione shtesë në fushën e IT.

GVJ i qëndron mendimit se panvarësisht nga orët e leksioneve që mund të ofrohen shtesë, studentët jashtë fushës së IT, duhet ti nënshtrohen parakushteve, pasi egziston rreziku i uljes së nivelit akademiko-profesional për të plotësuar mungesën e formimit të fushës



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

GVJ mbështetur në të dhënat e paraqitura në RVB por edhe të materialeve të paraqitura në Dosjen e Vetvlerësimit (DVV) dëshmon se: Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit” është konceptuar sipas vizionit dhe misionit të përgjithshëm të SHLUJ "Marin Barleti" si dhe zhvillimeve që ndodhin në vend lidhur me teknologjinë e informacionit, nevojave të mëdha që dikton situata aktuale për drejtues të kualifikuar në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe në kuadër të zhvillimeve të vrullshme të teknologjisë dhe aplikimit të saj në fusha të ndryshme, e cila dikton nga ana e saj kërkesa të reja për të menaxhuar më mirë inovacionet dhe kërkesat në ritje për këto teknologji. Vizioni i SHLUJ Marin Barleti është: Arsimit cilësor - dije të qëndrueshme - kërkimim shkencor dhe inovacion. Pra vizioni i tij është të zërë vend elitare në vendin tonë në fushën e arsimit, kërkimit dhe zhvillimit, duke qënë në shërbim të plotë të shoqërisë

Misioni i programit

Misioni i programit është të përgatisë profesionistë për të menaxhuar dhe realizuar funksionet teknike, fizike të një firme apo organizate, veçanërisht ato të lidhura me zhvillimin, prodhimin, marketingun.

Objektivat e programit

Në përfundim të programit të studimit, studenti duhet:

- Të zotërojë një formim teorik të specializuar në fushën e menaxhimit të teknologjisë së informacionit;
- Të jetë i aftë për të bërë gjykime profesionale, për të marrë vendime menaxheriale në kontekst të teknologjisë së informacionit;
- Të zotërojë aftësi për të menaxhuar projekte dhe për të bërë analiza të strategjive në fushën e teknologjisë së informacionit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	GVJ konstaton se: Misioni i SHLUJ “Marin Barleti” është t’u japë studentëve një edukim cilësor të qëndrueshëm; t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve më të mira të dijes dhe të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës. Programi i ciklit të dytë të studimit “Master Profesional” në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit”, është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit. Një ndër Objektivat e mësimdhënies së programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit” është: Formimi i
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	

	<p>specialistëve për menaxhimin e projekteve që janë të lidhura me teknologjinë e informacionit.</p> <p>Objektiva në tërësi janë në përputhje me disa nga nevojat e tregut të punës për specialistë të tillë, ndërkohë që programi i studimit është në një pjesë të konsiderueshme në përputhje me tregun e punës.</p> <p>Për hapjen e programit të studimit institucioni është bazuar në trendin e përgjithshëm të kërkesave për profesionin e drejtuesit të projekteve lidhur me projektet e IT (IT Project Management) duke e pasur si bazë referencë tregun e punës.</p> <p>Programi Master është ndërtuar që t'i shërbejë ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare. Programi i trajton, mbështet dhe i kultivon këto vlera nëpërmjet përbajtjes mësimore, kërkimit dhe veprimtarive.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit MP në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit” është përshtatur me strategjinë e institucionit në drejtim të krijimit të profesionistëve kryesisht për menaxhimin e projekteve IT.</p> <p>Në fakt, institucioni duhet të kishte të përcaktuar më qartë strategjitë e zhvillimit të këtij PS, i cili më shumë u tregua për të nga vizita dhe takimet e realizuar nga GVJ gjatë kësaj vizite në institucion, se nga ndonjë dokument të dorëzuar apo të paraqitur në DVV</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit” është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p> <p>MP në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit” është program i ciklit të dytë të studimeve dhe pajis të diplomuarin me njohuri të thelluara, profesionale në fushën menaxhimit të projekteve të teknologjisë së informacionit. Studimet përmbyllen me punim diplome dhe studentët marrin diplomë “Master profesional” në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit”</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Nga SHLUIJ Marin Barlet nuk është dorëzuar një plan strategjik zhvillimi i mirëfilltë (theksuar me lartë). Ky dokument mungon dhe tek lista e dokumentave në sesionin “Dorëzimi i DVV nga Institucioni”.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>1. Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master Profesional në “Menaxhim i teknologjisë së Informacionit” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit.</p>	

2. Ky program studimi është në pjesën më të madhe në përputhje me nevojat e tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit.
3. Programi i studimit MP në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit” synon për tu përshtatur me strategjinë e institucionit në drejtim të krijimit të profesionistëve (evidentuar kjo nëpërmjet vizitave në institucion) por duhet të shihet mundësia e ri-formulimit të programit në të ardhmen duke zëvendësuar disa prej lëndëve të kësaj kurikule me lëndë më të përshtatshme për formimet profesionale në fushën e TI. Institucioni duhet të përmirësojë planin mësimor përse i përket shpërndarjes së orëve laboratorike në lëndët që kanë më orientim praktik se teorik në të ardhmen.
4. Programi i studimit MP në “Menaxhim i teknologjisë së informacionit” është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
5. Institucioni duhet të hartojë një Plan Strategjik të Zhvillimit ku të shpjegohet në mënyrë të detajuar procesi i zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimeve si dhe të përmirësimit të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

GVJ mbshtetur në dokumentacion të paraqitur nga Institucioni, shprehet se: Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë ka si qëllim të thellojë dijet tek studentët, nëpërmjet cilësisë në mësimdhënie dhe punës kërkimore në fushat e teknologjisë së informacionit, financës, ekonomiksit, menaxhim biznesit, arkitekturës dhe turizmit.

Fakulteti ofron një kurrikulum, i cili bën të mundur që studentët të mësojnë një gamë të gjërë lëndësh nga teoria në aplikimin e tyre në praktikë. Fakulteti përkushtohet për ti përgatitur studentët me njohuri të nevojshme për arritur një karrierë profesionale në të ardhmen.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë përbëhet nga tre departamente: Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike, Departamenti Biznes, Menaxhim e Turizëm, Departamenti i Ekonomisë dhe Financës.

Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike siguron arsimimin dhe kërkimin shkencor në fushën e arkitekturës, urbanistikës, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit. Departamenti përmes kurrikulave së tij ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri akademike të kompetencave kryesore të formimit profesional dhe të ballafaqimit me kompleksitetin dhe transformimet e vazhdueshme të qytetit, territorit, peisazhit bashkëkohore dhe të zhvillimit të vazhdueshëm të Teknologjisë së Informacionit. Realizimi i një pjese të madhe të punës grafike, analitike bëhet nëpërmjet aplikimit të teknologjisë së informacionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Siç jemi shprehur edhe në pjesën përshkrimore, njësia kryesore për ofrimin e këtij programi është Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë. Ky Fakultet përbëhet nga tre njësi bazë të cilat janë:

1. Departamenti i Ekonomisë dhe Financës;
2. Departamenti i Biznes, Menaxhim, Turizëm;
3. Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave kompjuterike.

Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave kompjuterike

☑ Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat,
Referuar të dhenave të paraqitura në RVB por mbështetur edhe me atë çka GVJ pa gjatë vizitës në Institucion, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë, ka në përbërjen e tij gjithsej 28 PAE dhe 29 PAK (Anekse, Tabela 1)

Departamenti i Ekonomisë dhe Financës – 8 PAE dhe 7 PAK

Departamenti i Biznes, Menaxhim, Turizëm – 7 PAE dhe 5 PAK

Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave kompjuterike – 13 PAE dhe 17 PAK

Në njësinë bazë, në Departamentin e Arkitekturës dhe Shkencave kompjuterike, përgjegjëse për këtë program studimi, titujt dhe gradat për vitin akademik 2018-2019, janë si më poshtë:

13 PAE - -1 Prof Dr; 1 Prof As; 4 Dr dhe 7 Msc

17 PAK – 1 Prof As; 3 Dr; 13 Msc

Të dhëna më të detajuara gjenden në Anekse, Tabela 2

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>SHLUJ Marlin Barleti përfaqëson një IAL i cili përmes strukturave të tij kryen veprimtarinë për të cilën është licencuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.</p> <p>GVJ gjatë vizitës ju komunikua se aktualisht Institucioni ka 2 Fakultete dhe konkretisht Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe Politike si dhe Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë.</p> <p>Fakultetet organizohen në njësi bazë (departamete), sipas përcaktimeve ligjore dhe akteve nënligjore.</p> <p>Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike si pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë dhe përgjegjëse për këtë PS, në përbërjen e tij ka 13 anëtarë efektiv si personel akademik, ndër të cilët 6 janë me titujt dhe grada (1 Prof Dr; 1 Prof As; 4 Dr dhe 7 Msc)</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion bëri pyetje dhe mori përgjigje për angazhimin dhe njohjen e përgjegjësive të njësisë bazë për këtë program. Edhe gjatë takimeve të kryera në departamentin e burimeve njerëzore u konfirmua angazhimi i njësisë bazë gjatë procesit të rekrutimit të stafit akademik.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

1. SHLUJ Marin Barleti aktualisht ka në përbërje të tij dy Fakultete. Institucioni ka Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe Politike dhe Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë.
2. Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike është përgjegjës për ofrimin e programit të studimit. Ky Departament në përbërjen e tij ka 13 anëtarë efektiv si personel akademik, ndër të cilët 6 janë më titull dhe gradë.
3. Njësitë kryesore dhe bazë realizojnë aktivitetin e tyre në bazë të LAL dhe Statutit të Institucionit.
4. Si njësia kryesore edhe ajo bazë përfshihen si në procesin e rekrutimit të personelit akademik, ashtu edhe në procesin e vlerësimit të tij.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raportet PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

GVJ mbështetur në RVB por edhe në vizitat e kryera në Institucion, shprehet se: në këtë program studimi janë të angazhuar gjithsej 6 (gjashtë) pedagogë. Nga këta, 5 (pesë) pedagogë janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 1 (një) është personel akademik me kontratë (PAK). Programi i studimit, në vitin akademik 2018-2019 ka vitin e parë të aktivitetit të tij akademik

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Anekse, Tabela 3)

Ky program studimi ka të angazhuar si personel akademik gjithsej 6 (gjashtë) staf akademik, nga të cilët 5 (pesë) janë personel akademik efektiv dhe 1 (një) është personel akademik me kontratë.

Viti akademik 2018-2019

5 PAE – 1 Prof. As; 3 Dr; 1 Msc

1 PAK – 1 Prof As

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit (Anekse, Tabela 6)

Mbështetur në RVB por edhe gjatë takimit me Stafin akademik, konstaton se Këshilli Shkencor i programit përbëhet nga tre anëtarë (1 Prof As në cilësinë e Kryetarit; 1 Dr dhe 1 Msc)

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Anekse, Tabela 4)

Stafi i angazhuar në këtë program Master profesional me kohëzgjatje vetëm 1 vit akademik, është në maxhorancë staf i brendshëm (5/1). Përgjithësisht është me tituj dhe grada, me përjashtim të një pedagogjeje e cila aktualisht është Msc dhe ishte në proces të Doktoraturës.

- Të dhëna sipas moshës së personelit (Anekse, Tabela 5)

Mbizotëron moshë e re si në stafin me kohë të plotë, ashtu edhe në stafin me kohë të pjesëshme. Grup moshat variojnë nga 25-35 vjeç deri në 45-55 vjeç.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Personeli administrativ kryen veprimtari administrative dhe teknike në ndihmë të procesit mësimor dhe atij kërkimor. Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështet veprimtarinë e mësimdhënies dhe të zhvillimit të institucionit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve.</p> <p>Personeli akademik është përgjegjës për hartimin e kurrikulave por edhe zbatimin e tyre në procesin mësimor.</p> <p>Personeli ndihmës mësimor - shkencor është informuar për realizimin e objektivave të programit të studimit përmes dokumentacionit rregullator si dhe mbledhjeve të departamentit.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë dhe në mënyrë të veçantë Departamentit të Arkitekturës dhe Shkencave Kompiuterike, kanë ideuar dhe kanë kontribuar në hartimin e kurrikulës së programit. Vendimet për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave merren me propozim të departamenteve dhe kalojnë për miratim në Senatën Akademik.</p> <p>Përsa i përket ngarkesës mësimore, në përgjithësi pedagogët kishin të përcaktuar ngarkesë mësimore sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Përveç rastit të pedagoges E. K, ngarkesa e të cilës ishte 410 orë. Ngarkesa maksimale për pedagog duhet të jetë jo më shumë se 390 orë duke përfshirë këtu edhe angazhimet e tjera akademike.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;

Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

GVJ Ju komunikua se: Institucioni ndjek procedura ligjore për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren.

Bëhet njoftim publik në media vizive dhe të shkruar.

Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është gjithsej 6 pedagogë, nga të cilët 5 janë pedagogë efektiv dhe 1 pedagog me kontratë, raporti numerik PAE/PAK është 83.3%

Përsa i përket ngarkesës pedagogët efektiv (PAE) kanë kryer 300 orë ose 75% të ngarkesës, ndërsa pedagogët me kontratë (PAK) kanë kryer 100 orë ose 25% të ngarkesës mësimore të programit të studimit. Këto të dhëna bazohen mbi Tabelën e ngarkesës së pedagogëve të dorëzuar nga institucioni.

Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Për vlerësimin e personelit institucioni merr në konsideratë edhe vlerësimin e bërë nga studentët nëpërmjet pyetësorëve.

Nga vizita në Institucion, në Zyrën e Burimeve Njerëzore baza e të dhënave konsistente në formë fizike në dosjet fizike të personelit. Në ndonjë rast, dosja kishte mangësi ose ishte e pa përditësuar. Kështu, në kontratën e pedagoges A. K pozicioni i punës ishte specifikuar gabim.

Bazë të dhënash elektronike të mirfilltë sipas kriterit 4 nuk kishte.

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;

Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";

Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;

Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;

Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

Përgjegjësi i programit ka gradën Profesor i Asociuar dhe ka përvojë akademike. Në këtë program japin mësim dy pedagogë me titullin Profesor i Asociuar, tre pedagogë me gradën Doktor dhe një në process mbrojtje doktorature.

Titullarët e lëndëve janë me tituj dhe grada shkencore.

Rektori, zv/rektori, dekani, dhe drejtorët e institucioneve janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;

Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Numri i vogël i studentëve në këtë PS plotëson kriterin e udhëheqjes së temave nga stafi akademik me të paktën titullin “Doktor”. Këtë program studimi e ndjekin 10 studentë.</p> <p>Duke qënë se numri i studentëve është relativisht i vogël, mbikqyrja e tyre është lehtësisht e realizueshme nga ana e stafit me titull dhe grada.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Udhëheqësit kanë eksperiencë disa vjecare në mësimdhënie, duke patur të gjitha aftësitë teorike dhe praktike në fushat me të cilat lidhet ky PS.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>UMB ka ndërtuar laboratore me kompjutera në të cilët bëhen orët e laboratorit për këtë PS. Punët laboratorike udhëhiqen nga stafi akademik, sipas specifikave të lëndëve.</p> <p>Institucioni dëshmon angazhim të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në këtë PS vlerësohen me orë mësimore.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është gjithsej 6 pedagogë, nga të cilët 5 janë pedagogë efektiv dhe 1 pedagog me kontratë, raporti numerik PAE/PAK është 83.3%</p> <p>Përsa i përket ngarkesës pedagogët efektiv (PAE) kanë kryer 300 orë ose 75% të ngarkesës, ndërsa pedagogët me kontratë (PAK) kanë kryer 100 orë ose 25% të ngarkesës mësimore të programit të studimit.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të</p>	<p>UMB ka të dhëna për personelin akademik të përfshirë në program të studimit në dosjen personale të cdo pedagogu, si dhe për personin përgjegjës për PS.</p> <p>UMB për këtë PS dispononte një listë të plotë të stafit akademik.</p>

personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;
Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

UMB ka përcaktuar kriteret dhe procedura të qarta për rekrutimin e personelit akademik, i publikon ato rregullisht në ëbsite, kur lind nevoja për rekrutime të reja.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Personeli akademik, ndihmës dhe administrativ rezulton se angazhohet për përmbushjen e objektivave të programit të studimit.
2. Personeli akademik është i angazhuar në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit. Duhet të specifikohen saktë pozicionet e punës së personelit në kontratat e punës. Të korigjohen gabimet ekzistuese në kontratat e punës dhe të përditësohen dosjet e personelit akademik.
3. UMB ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit. Zyra e burimeve njëzore, merret me politikën e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.
4. Plotësohet kriteri mbi personelin akademik efektiv, që përbën 83% të personelit akademik të angazhuar në këtë program.
5. Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.
6. Studentët që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën, me grada dhe tituj shkencore dhe aftësi teorike e profesionale në fushat e drejtimit të tezave.
7. Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Për realizimin e programeve të studimit SHLUJ UMB ka dy kampuse në të cilat janë të lokalizuara sallat e leksioneve dhe të seminareve, laboratorët, biblioteka, sekretaria mësimore, zyrat për personelin dhe dekanin.

Gjatë vizitës në UMB u vizituan disa nga ambjentet kryesore në të cilat zhvillohej ky program studimi si: salla leksionesh, seminare, laborator i informatikës, sekretaritë mësimore, etj.

Sallat e leksioneve dhe seminareve ishin përgjithësisht komode dhe të pajisura me tavolina e sedilje për tu ulur, tabela për të shkruar, projektor dhe kompjuter. Sallat kishin kushte të përshtatshme ndricimi dhe kondicionimi.

Institucioni ka dy laboratorë të pajisur me kompjutera. Këta laboratore shërbejnë për të gjithë programet e studimit që ofron UMB dhe jo vetëm për këtë PS.

Bibliotekat gjendeshin të shpërndara në dy vendndodhje, aty ku dhe vetë institucioni ushtron aktivitetin e tij. Vihet re se bibliotekat në të dy kampuset e Institucionit kanë mungesa fizike në libra të lidhur me degën e informatikës, fondi i librave dhe i titujve ishte fare i vogël dhe jo i përditësuar me botimet e viteve të fundit. Gjatë vizitës u informuam se institucioni u ofronte studentëve edhe bibliotekë on-line në të cilën kishte libra lidhur me Informatikën, gjë e cila plotësohte në një farë mase mungesën e librave apo botimeve të tjera në bibliotekat aktuale.

Zyra e sekretarisë mësimore në funksion të programit të Masterit Profesional ishte e pajisur me tavolina, karrike, kompjutera, printera. Në të kryhen procedurat administrative, mbahen regjistrat mësimore, procesverbalet, lëshohen vërtetime etj sipas kërkesave që i vijnë kësaj sekretarie nga studentët dhe informacione të tjera.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit janë të paraqitura në mënyrë të hollësishme me sipërfaqe në Anekse, tabela 7

- Salla për leksione, Klasa për seminare - 34
- Salla për aktivitete promovuese - 6
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale - 8
- Laboratorë për lëndët - 5
- Laboratorë informatike - 7
- Salla interneti - 2
- Salla për bibliotekë - 2
- Mjedis për fotokopjime, librari etj - 2
- Zyre informacioni për studentët - 6
- Nyje hidrosanitare - 49

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin - 5
- Zyra për sekretarinë mësimore - 2
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore - 3
- Zyra për personelin akademik - 36

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedisje janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedisje të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Institucioni zhvillon aktivitetin e tij në dy kampuse. Njëri prej kampuseve vlerësohej si më qendror për shkak të vendodhjes së pjesës administrative të Institucionit (Rektore, Dekan, etj)</p> <p>Objektet e mësipërme shërbejnë me kushte dhe kapacitete të mira për zhvillimin e veprimtarive mësimore e tekniko-administrative të këtij institucioni. Nuk evidentohen marrëveshje bashkëpunimi të veçanta për këtë PS, me qëllim mbështetjen e aktiviteteve të ndryshme të procesit mësimor, duke përfshirë dhe praktikat profesionale.</p> <p>Konstatuam se duhet të shihet si prioritare mundësia e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private për kryerjen sidomos të këtyre praktikave profesionale për studentët e Masterit Profesional.</p>

Orët e praktikës mësimore apo laboratorike zhvillohen në laboratorin e informatikës. Aftësimi praktik synohet edhe nëpërmjet mjaft lëndëve të cilat zhvillohen në këto laboratore.

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

Nga RVB-ja dhe vizita në institucion u pa se ky institucioni ofron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse kryesisht nëpërmjet dy bibliotekave. Siç theksuam, librat për këtë program studimi mungonin në bibliotekë. Edhe kur ato egzistonin shpesh ishin jo të botimeve të viteve të fundit. Këtë literaturë ata mund ta aksesonin në Bibliotekën online, e cila ishte përsëri ka nevojë për tituj të rinj, gjithashtu gjatë vizitës së GVJ kjo bibliotekë nuk ishte funksionale

Biblioteka ka vënë në dispozicion të studentëve të "Masterit Profesional" ambjent për ta përdorur për qëllime studimi.

Biblioteka shërben me orare të përshtatshme për studentët dhe pedagogët, dhe ka ambjente të mira të cilat sigurojnë kushte për studim.

Nuk evidentohet ndonjë plan i detajuar për shtimin e zërave të rinj të bibliotekës, aq më tepër për këtë PS. Duhet riparë buxheti i planifikuar për shtimin e zërave të rinj.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Gjatë vizitës konstatuam se:

- Institucioni zotëron një numër të mjaftueshëm mjedisesh si salla leksionesh, seminare, laboratore, etj, për realizimin e programit Master Profesional në "Menaxhim i teknologjisë së Informacionit".
- Ofrohet infrastrukturë për mësimdhënie, që përfshin pajisje elektronike dhe teknologjike, në shërbim të nevojave të personelit dhe të studentëve.
- Institucioni ushtron aktivitetin akademik në një godinë e cila plotëson normën e sipërfaqes shfrytëzuese, kushtet teknike për ushtrimin e aktivitetit.
- Mjediset mësimore, auditore, salla leksionesh dhe seminaresh janë të pajisura me mjete të përshtatshme teknike si kompjutera, videoprojektorë, lidhje interneti, sisteme ndriçimi dhe ajrimi të përshtatshme.

Në funksion të zhvillimit cilësor të programit të studimit vihen në dispozicion Laboratori i informatikës. Në to parashikohen dhe praktikat profesionale apo aftësimi praktik sipas lëndëve.

Nuk evidentohen laboratore specifike të informatikës që do të shërbenin këtë PS, por për përdorim të përgjithshëm nga ana e të gjithë studentëve të UMB

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ka siguruar infrastrukturën e përshtashme për realizimin e programit të studimit.
2. Në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve janë mjedise mësimore, laboratorë, biblioteka të cilat janë të pajisura me teknologji dhe aparatura të cilat ofrojnë përgjithësisht mundësi në mësimdhënie dhe në formimin profesional të studentëve.
3. Biblioteka e Institucionit nuk ka libra të mjaftueshëm të lidhur me programin e studimit. Literaturën lidhur me këtë program studimi studentët mund ta aksesojnë vetëm në Bibliotekën online, e cila duhet të jetë më e përditësuar dhe funksionale. Duhet riparë buxheti në lidhje me shtimin e zërave të rinj.
4. Laboratorët në funksion të këtij programi studimi janë të pajisura me mjete për realizimin e orëve laboratorike. Ato duken të pajisur me harduere dhe softuere që ndihmojnë në realizimin e detyrave sipas lëndëve dhe aftësimin praktik të studentëve.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Institucioni është shoqëri tregtare. Si e tillë ajo arkëton të ardhura kundrejt shërbimeve të ofruara. Institucioni financohet nga tarifat e studentëve dhe auditohet çdo vit në mënyrë të rregullt nga një ekspert kontabël, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare. Në zërat shpenzime pjesën më të madhe e zënë shpenzimet për paga. Institucioni nuk ka siguruar të ardhura nga grantet për këtë PS.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (Aneksë, tabela 8):

Referuar të dhënave të paraqitura në RVB, Institucioni deklaron se të ardhurat për vitin 2018, për programet e studimit që ofron në rang Institucioni janë: Nga konsulentat dhe shërbimet (2,679,975 lekë); Tarifaët për dhe gjatë shkollimit (251,759,242); Shërbimet trainuese/kualifikimi i vazhdueshëm (2,934,832) dhe të tjera (598,764)

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Kosto e studimit për student për vit akademik llogaritur si raport i shpenzimeve për vit akademik dhe numrin e studentëve paraqitet sipas RVB dhe është llogaritur 1.250 Euro.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	

<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Institucioni kryen auditimin e jashtëm të situatës financiare nga një ekspert kontabël konform legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare.</p> <p>Në raportin e auditit paraqiten detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj</p> <p>Brenda raportit të auditit janë specifikuar zërat në lidhje me grantet si dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve. Për këtë PS nuk janë siguruar të ardhura nga grantet dhe kontratat</p>
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni harton një raport financiar brenda afateve të përcaktuara me ligj. Në raport përfshihen pasqyrat mbi të ardhurat dhe shpenzimet. Raportet financiare gjenden në Zyrën e Financës të institucionit.</p> <p>IAL duket se ka qëndrueshmëri financiare përgjate kohës së zhvillimit të programit.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni auditohet nga një ekspert kontabël. 2. Institucioni ka raport financiar për këtë program studimi dhe të ardhurat mesatare mbulojnë shpenzimet mesatare. 3. Bazuar në të dhënat financiare dhe ecurinë, shprehim opinionin që IAL ka qëndrueshmëri financiare. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Mbështetur në RVB, me Vendim të Rektorit Nr. 50, datë 07.05.2018, është ngritur në UMB Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Kjo zyrë ka autonomi vepruese dhe akses për të gjitha të dhënat në SHLUJ UMB. Roli i saj është të krijojë një kulturë që synon të arrijë dhe të ruajë një cilësi të lartë të veprimtarisë akademike dhe kërkimore në SHLUJ UMB.

Dokumenti i Politikës së Vlerësimit duhet të përmbajë kriteret e sigurimit të cilësisë, funksionet e organizmave të sigurimit të cilësisë dhe procedurat e vlerësimit të brendshëm.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSC për programin e studimit:
 - o Sa anketime kanë bërë me studentët – **dy anketime në vit**

- Sa studentë janë anketuar – **të gjithë studentët janë ftuar, por pjesëmarrja ka qenë e ulët**
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë – **Sipas RVB janë përpunuar të gjithë pyetorët dhe rezultati i është paraqitur me shkrim Rektorit.**
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm – **për shkak të afatit të shkurtër kohor, pasi është një program studimi që është aktivizuar për herë të parë në vitin akademik 2018-2019, nuk ka qenë e mundshme të evidentohen hapat e mëtejshëm për zgjidhjen e problemeve.**

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Komisioni i Sigurimit të Cilësisë është një organizëm i ngritur me Vendim të Rektorit Nr. 38, datë 06.03.2016 dhe funksionon në nivel institucioni. Komisioni është i përbërë nga 4 (katër) anëtarë dhe ka përgjegjësinë për të garantuar se SHLUJ UMB i plotëson standardet e cilësisë. Ky organizëm përgjigjet për politikën e vlerësimit dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe i raporton drejtpërdrejtë Senatit të SHLUJ UMB

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Bazuar në RVB dhe në takimet e realizuar me përfaqësuesit e kësaj zyre, garantimi dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë nuk është vetëm detyrë e NJSC, por e rëndësishme është të krijohet dhe zhvillohet kultura e cilësisë në çdo njësi të funksionimit akademik dhe administrativ të institucionit. Ngritja e GVB pranë Fakulteteve, përfshirja në to edhe e studentëve i shërben pikërisht këtij synimi. NJSC monitoron dhe menaxhon profesionalisht cilësinë duke bashkëpunuar me GVB e fakulteteve.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimet janë vjetore dhe kryhen nga NJSC. Ato shërbejnë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të marrë masat e nevojshme të përmirësimit të saj.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Theksojmë se ky program studimi ka vëtëm një vit jetë dhe për shkak të kohës së shkurtër të përpunimit të të dhënave, nuk është paraqitur informacion mbi hapat e mëtejshëm për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënis.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumentacioni i politikës së vlerësimit

Formulari i vlerësimit të pedagogëve dhe studentëve

Raport i vlerësimit të brendshëm

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p>	Në strukturën e organizimit të institucionit ushtron veprimtarinë e saj një njësi përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe është pjesë e strukturës së organizimit të institucionit dhe ka për detyrë të vlerësojë ecurinë e programeve të studimit nëpërmjet instrumentave

<p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>matës dhe vlerësues të cilat konsistojnë në vlerësim formues dhe përmbledhës</p> <p>Pyetsorë për studentët të cilat plotësohen në fund të semestrave dhe japin informacion për aftësitë profesionale të pedagogëve cilësinë e komunikimit me audiore, përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie dhe praktika mësimore.</p> <p>Intervistat kryhen sipas nevojave me kampione studentësh për secilin program studimi.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit, NJBSC përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta</p> <ul style="list-style-type: none"> Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, lendëve/kurrikulës, dhe të të mësuarit <p>Të drejtpërdrejta</p> <ul style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët bazuar në provimet e vlerësuara me nota ose pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e ndërmjetëmë dhe përfundimtare. Bazuar në kete metodologji, Njesia e brendshme e sigurimit të cilësise ka arritur në përfundimin se: <p>Programet studimore të cilat ofrohen nga institucioni janë të orientuara përgjithësisht drejt ndaj kërkesave dhe nevojave të tregut të punës.</p> <p>Institucioni ndërthur metodat e ndryshme për vlerësimin dhe rezultatet e arritura.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Nga shyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimi në faqen e internetit, rezulton se ky i fundit publikon objektivat që synon të arrijë në rritjen e nivelit të performancës.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni bën analiza për vlerësimin e studimeve të ciklit të dytë dhe më konkretisht edhe për programin “Master Profesional” që po vlerësohet.</p> <p>Për përmirësimin e programeve të studimit të ciklit të dytë institucioni harton politika që synojnë realizimin e këtij objektiv.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p>	<p>SHLUJ UMB është akredituar për herë të parë në nivel institucioni me Urdhërin nr. 288 datë 04.09.2009 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Me Vendimin e Bordit të Akreditimit numër 9 datë 7.04.2017 është riakredituar.</p>

<p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni për realizimin e objektivit për përgatitjen e studentëve me cilësi të lartë, përdor instrumentat e kërkuara për sigurimin e cilësisë. Ky funksion primar realizohet i përqendruar kryesisht nga një strukturë e cila në punën e saj përdor metoda për kontrollin e cilësisë dhe mbikëqyrjen e saj.</p> <p>Njëësia e cilësisë së bashku me njësitë e tjera të institucionit ushtron kontroll të vazhdueshëm për cilësinë e mësimdhënies në të gjithë komponentët e veprimtarisë mësimore e shkencore.</p> <p>Kjo njësi bën vlerësimin e programeve studimore duke u përqendruar gjithashtu dhe Syllabuset, me synimin që ato të mos interferojnë me disiplina të tjera, por të realizojnë lidhje ndërdisiplinore.</p> <p>Në lidhje me përputhshmërinë e literaturës me programin, shikohet nëse ka nivel shkencor të kohës, përshtatet me nivelin e dijeve dhe aftësive të studentëve.</p> <p>Senati i institucionit, mer në analizë praktika të testimit të cilësisë së programeve të studimit të disiplinave të ndryshme, të veprimtarive me karakter mësimor-shkencor.</p> <p>Në nivel departamenti diskutohen problematika që kanë të bëjnë me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të tyre, me metodat dhe teknikat më të reja në fushën e mësimdhënies.</p> <p>Njëësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë të institucionit ka hartuar dhe miratuar një strategji të për përmirësimin e cilësisë.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni realizon sigurimin dhe mbikëqyrjen e cilësisë në përputhje me standartet e kërkuara, duke përdorur në mënyrë të vazhdueshme instrumenta të matjes dhe të vlerësimit si intervista, anketime, analiza të produkteve të veprimtarisë së tyre si teza e punime. 2. Njëësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë ka krijuar mekanizmat e nevojshëm institucionalë për të garantuar cilësinë. 3. Kjo njësi bën vlerësimin e programeve studimore duke u përqendruar kryesisht në Syllabuset, me synimin që ato të mos interferojnë me disiplina të tjera, por të realizojnë lidhje ndërdisiplinore. 	


POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Assever



GVJ mbështetur në RVB thekson se: Misioni i programit të studimit të nivelit të dytë Master Profesional në "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit" është që të përgatisë individë për të menaxhuar dhe realizuar funksione teknike, fizike të një firme apo një organizatë në fushën e teknologjisë së informacionit. Ai përfshin mësimdhënie që lidhen me parimet e menaxhimit të proceseve të softuerit; analizën dhe dizajnin të sistemeve; analizën, dizajnin dhe menaxhim të databazave; sigurinë e informacionit; sistemet për modelim të bizneseve, inovacionin dhe biznesin elektronik; analizën e të dhënave për biznesin etj.

Programi i studimit ofrohet pranë Departamentit të Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike; kohëzgjatja e tij është 1 vit akademik/2 semestra; ofrohet me 60 ECTS; me kohë të plotë. Ky program është i ri dhe është në vitin e parë të funksionimit të tij.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Master Profesional në "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit" është hapur për herë të parë pranë SHLUJ UMB në vitin akademik 2018-2019.

Ky program ka për qëllim që të përgatisë individë për të menaxhuar dhe realizuar funksione teknike, fizike të një firme apo organizate në fushën e Teknologjisë së Informacionit. Ai përfshin mësimdhënie të parimeve të menaxhimit të proceseve të softuerit, analizë dhe dizajnim të sistemeve, analizë, dizajn dhe menaxhim të databazave, sigurinë e informacionit, sistemet për modelim të bizneseve, inovacionin dhe biznesin elektronik, analizën e të dhënave për biznesin etj.

Objektivat e programit të studimit Master Profesional në "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit" janë përgatitja e studentëve të cilët në përfundim të këtij programi studimi duhet:

- të zotërojnë një formim teorik të specializuar në fushën e menaxhimit të teknologjisë së informacionit;
- të jetë të aftë për të bërë gjykime profesionale, për të marrë vendime menaxheriale në kontekst të teknologjisë së informacionit;
- të zotërojnë aftësi për të menaxhuar projekte dhe për të bërë analiza të strategjive në fushën e teknologjisë së informacionit (hardëare dhe softëare).

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Anekse, Tabela 9)

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit (Anekse, tabela 10):

- Për leksionet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret/Ushtrime 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 75 orë në auditor dhe 50 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 125 orë në auditor dhe 250 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Nuk ka ndryshime në planin mësimor, pasi është viti i parë i funksionimit të tij.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Anekse, Tabela 12)

Plani mësimor është hartuar duke marrë në konsideratë aftësitë akademike dhe shkencore të personelit, të cilët kanë të gjithë kapacitetet e nevojshme për zhvillimin e lëndëve sipas syllabuseve të paraqitura. Bazuar në CV e tyre, personeli akademik është në përputhje me fushat e tyre dhe zotërojnë mjaftueshëm tituj dhe grada për të përballuar zhvillimin e lëndëve që lidhen me këtë PS.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë kanë të pasqyruara këto elemente.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Bazuar në RVB, GVJ mendon se shpërndarja e lëndëve sipas tipit të veprimtarive përkon me mënyrën e shpërndarjes së lëndëve sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në momentin e licencimit të programit të studimit Master Profesional në "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit" (VKM nr 4/2018). Lëndët mësimore synojnë formimin bazë në fushë, formimin e specializuar në fushë, formimin kërkimor. Lëndët e formimit të specializuar në fushë kanë peshë më të madhe. Formimi dhe aftësimi kërkimor realizohet nëpërmjet lëndëve të posaçme të kërkimit, nëpërmjet kërkimit në lëndët e tjera dhe nëpërmjet punimit të tezës së kërkimit empirik. Veprimtaritë formuese përcaktohen në tabelën përkatëse (Anekse, tabela 11)

Programi i modulit, lëndës hartohet nga titullari i saj sipas formatit standard të miratuar nga UMB dhe në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Syllabuset përmbajnë të gjithë elementët e nevojshme sipas VKM nr 41/2018 dhe janë të standartizuar për tërë PS.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Paketa e programeve mesimore të lëndës

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri I Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	GVJ mbështetur në RVB konstaton se Programi i studimit Master Profesional në "Menaxhim i

Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;

Teknologjisë së Informacionit" është hapur për herë të parë pranë SHLUJ UMB në vitin akademik 2018-2019.

Programi është organizuar në module, të cilat janë vlerësuar me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Ky program përmban 60 kredite të shpërndara në 2 semestra, realizohet në gjuhën shqipe dhe zgjat një vit akademik

Ky PS përkon me misionin dhe qëllimin e vet institucionit.

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;

Kriteri 3 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;

Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;

Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;

Kriteri 6 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Kriteri 7 Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Masteri Profesional në "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit" është një master i ri në tregun e Edukimit dhe ka si qëllim kryesor që të përgatisë individë për të menaxhuar dhe realizuar funksione teknike, fizike të një firme apo organizate në fushën e teknologjisë së informacionit.

Ai përfshin mësimdhënie të parimeve të menaxhimit të proceseve të softuerit; analizë dhe dizajnim të sistemeve; analizë, dizajn dhe menaxhim të databazave; sigurinë e informacionit; sistemet për modelim të bizneseve, inovacionin dhe biznesin elektronik; analizën e të dhënave për biznesin, etj.

Ky PS frekuentohej jo vetëm nga studentë që kishin formim në fushën e IT.

Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Ai i përgjigjet kërkesës për përgatitjen e specialistëve për menaxhimin e projekteve IT.

Nga ana e ekspertëve u sugjerua që të rishihej mundësia e ofrimit të lëndëve të reja, të cilat do të ngrinin në një nivel më të lartë dhe do ta përshtatnin më mirë këtë PS me tregun e punës.

GVJ mendon se moduli "Metoda Kërkimi Shkencor" mund të mos zhvillohet për shkak se masteri synon të jetë profesional dhe me numër të vogël kreditesh (60 të tilla). Në vend të tij psh., mund të zhvillohet një modul si "Infrastruktura e TI", e cila jep një formim të përgjithshëm për infrastrukturën e kësaj teknologjie në nivel organizate, aq më tepër që këto njohuri mund të mos jenë marrë për studentët që vijnë nga profile ose formime jo informatike. Një modul tjetër mund të jetë "Seminar special" ose "Kurs Special", i cili mund të synojë ofrimin e njohurive të reja në një drejtim të caktuar (psh për një lëndë që del e nevojshme të shtohet, pa prishur planin mësimor), duke ftuar profesionist ose CEO të organizatave apo bizneseve.

Po ashtu, moduli "Sistemet e Informacionit në Organizata" trajton pjesërisht konceptet e nevojshme,

	<p>ndaj duhet riparë sylabusi, i cili duhet të përditësohet me botimet e reja në këtë fushë si dhe shtimin e rasteve të studimit, që e bën më konkret modulën.</p> <p>GVJ mendon se përmirësimi në të ardhmen me module të përditësuara ose dhe të ndryshuara në ndonjë rast, do t'i jepte më shumë vlera këtij PS.</p>
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodën e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat e nivelit të dytë të studimeve.</p> <p>Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e disa elementëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rezultat e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara • Vlerësimi me pikë për aktivizimin në auditor • Vlerësimi i detyrave të kryera. • Vlerësimi për përfshirjen në aktivitete jashtë shkollore • Vlerësimet bëhen në procesverbale dhe dorëzohen në sekretari
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Ky PS është mbështetur në programe të ngjashme si psh ai i Universitetit të Europës Juglindore (SEEU), duke reflektuar dhe nevojat e tregut vendas.</p> <p>Programi MP është ende në vitin e parë të funksionimit të tij dhe nuk ka patur bashkëpunim konkret me universitete të huaja.</p> <p>Programi është në harmonizim me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>GVJ mbështetur në RVB konstaton se Programi i ofruar i studimeve synon pajisjen e studentëve me aftësi profesionale dhe të kërkimit në të gjithë fushën e Teknologjisë së Informacionit. Aftësimi praktik realizohet si nëpërmjet komponentit të praktikës ashtu edhe trajtimin profesional të rasteve konkrete. Ndërsa aftësimi për kërkimin shkencor realizohet si nëpërmjet lëndës së posaçme të metodave të kërkimit, të elementeve të kërkimit të të gjitha lëndëve dhe të provës finale që kërkohet në trajtën e një kërkimi të aplikuar.</p> <p>Programi përputhet plotësisht me profilin e SHLUJ UMB dhe me strategjinë e zhvillimit të këtij institucioni</p> <p>Dokumentacioni i Programit të ciklit të dytë, dosjet personale të pedagogëve dhe lista e të dhënave për kërkimin shkencor dëshmojnë se pedagogët e këtij</p>

	<p>programi janë të angazhuar në veprimtarinë kërkimore shkencore dhe veprimtaria e tyre në fushën e kërkimit integrohet me mësimdhënien dhe ndihmon në realizimin e synimeve të programit të studimeve,</p> <p>GVJ mendosn se plani duhet përmirësuar për sa i përket shpërndarjes së orëve laboratorike në lëndët që kanë më orientim praktik se teorik në të ardhmen.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Sipas një studimi të tregut të punës të bërë nga ana e institucionit, vërehet se hapja e këtij PS synon të plotësojë kërkesat që ka ky treg për specialistë të IT.</p> <p>Sipas studimeve të bëra në përgjithësi, vartësia nga IT është esenciale dhe specialistët që dijnë të menaxhojnë këtë teknologji përbëjnë kërkesën më të madhe në treg.</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat më aktuale të tregut të punës. Ai i përgjigjet kërkesës për përgatitjen e menaxherëve për drejtimin e projekteve IT, një specializim që kërkohet kryesisht në sektorin privat por dhe në institucionet publike.</p> <p>Programi mban parasysh zhvillimin ekonomik të vendit, nevojat për përgatitjen e specialistëve të aftë për të punuar në çdo fushë ku kërkohet menaxhimi i projekteve IT.</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ iu vendos në dispozicion dokumenti mbi studimin e tregut të punës. Institucioni është përpjekur të hartojë PS në përputhje me kërkesat që ky treg ofron dhe mbi bazën e studimit të bërë. Ata kanë studuar rreth 100 kompani për të evidentuar mundësitë e punësimit. Anketimi ka qënë i orientuar sipas moduleve që ky PS ofron, për të parë përputhshmërinë midis formimit në mastër dhe kërjesave të tregut. Duke qënë se ky PS është hapur rishtaz, nuk ka të dhëna në lidhje me punësimin e tyre as mbi mundësitë e punësimit në kompani të tjera.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga institucioni dhe politikat e ndjekura janë hartuar në përputhje me politikat kombëtare mbi arsimin e lartë të MASR.</p> <p>Programi Master është ndërtuar që t'i shërbejë ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare, të tilla si demokracia, diversiteti, shpirti i sipërmarrjes, toleranca, bashkëpunimi, drejtësia, respektimi i të drejtave të njeriut, zhvillimi i qëndrueshëm, integrimi evropian.</p>

	Programi i trajton, mbështet dhe i kultivon këto vlera nëpërmjet përbajtjes mësimore, kërkimit dhe veprimtarive.
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	
Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	Programi Master Profesional përmban 60 kredite ETCS, të shpërndara në 2 semestra, realizohet në gjuhën shqipe dhe zgjat një vit akademik.
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Në faqen e ëeb-it të Institucionit nuk ka informacion për syllabuset e këtij program studimi. Informacioni jepet gjatë fillimit të semestrit nga pedagogët përkatës.
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Rregullorja e diplomimit hartohet në përputhje me Ligjin për IAL-të, dhe rregulloren e institucionit dhe parashikohet plani i diplomimit sipas kalendarit akademik.
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim i Teknologjise se Informacionit” përputhet me strategjinë për zhvillim të UMB. 2. Në hartimin dhe zbatimin e këtij Programi janë mbajtur parasysh plotësimi i kushteve dhe parakushteve të rrjedhura nga Ligji i Arsimit të lartë dhe Udhëzimet përkatëse të MASR. 3. Përbajtja e programit të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Udhëzimet përkatëse të MASR. 4. Programi i studimit përfshin aftësim profesional dhe më pak shkencor, për nga vetë natyra specifike e këtij masteri. 5. Program i studimit ofrohet kryesisht në përputhje me nevojat e tregut të punës për specialist IT, edhe pse mund të rishikohet në disa aspekte në të ardhmen, kryesisht në ofrimin e lëndëve me profesionale që lidhen me një master profesional në menaxhimin e IT dhe në shtimin e orëve laboratorike në disa module 6. Në lidhje me këtë program studimi, informacioni vendosur në faqen e ëeb i jep njohuritë e kërkuara. Prezenca e broshurës është një gjetje e mirë. Informacioni në të është bazik dhe i mjaftueshëm. 7. Ky PS parashikon planin ligjor të diplomimit sipas kalendarit akademik 	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Plani mësimor përshin 8 lëndë mësimore, praktikën dhe provën finale. Plani mësimor ndërtohet mbi disa blloqe kryesore: formimi bazë në fushë 10 kredite, formimi i specializuar në fushë 25 kredite, formim kërkimor dhe disiplina integruese të ngjashme 5 kredite, përvoja praktike 5 kredite dhe prova finale 15 kredite.

Në vlersimin tonë, ashtu siç e kemi paraqitur edhe më lart, lëndët mësimore synojnë formimin bazë në fushën e menaxhimit të teknologjisë së informacionit, formimin e specializuar në fushë, formimin kërkimor. Bazuar në RVB, lëndët e formimit të specializuar në fushë kanë peshë më të madhe. Formimi dhe aftësimi kërkimor realizohet nëpërmjet lëndëve të posaçme të kërkimit, nëpërmjet kërkimit në lëndët e tjera dhe nëpërmjet punimit të tezës së kërkimit empirik.

Plani mësimor ndryshohet vetëm kur ndryshimi është i argumentuar. Ndryshimi i planit mësimor bëhet me vendim të Senatit të UMB.

Format e mësimimit

- Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, diskutimeve, debatit, punës në grupe, studimit të rastit, kazuseve, lojës me role, simulimeve, prezantimeve, projekteve të kërkimit, praktikës.
- Kohëzgjatja e seancave mësimore është 50 minuta.
- Veprimtaria mësimore dhe kërkimore e programit Master Profesional në "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit" zhvillohet në gjuhën shqipe. Në rastin e angazhimit të pëdagogëve të huaj sigurohet përkthim.

Në takimet e realizuar në institucion nga ana GVJ, na u bë me dije se kontrolli i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet provimeve të cilat organizohen në formën e përcaktuar në syllabusin e lëndës. Provimet organizohen dhe kryhen në sezonet e përcaktuara në kalendarin akademik.

Gjatë intervistave me studentët na u tha që provimet për simestrin e parë janë dhënë në shkurt.

Nga provimi në provim është lënë një javë. Në Semestrin e dytë kanë 5 lëndë dhe semestri i dytë ka nisur java e parë e marsit dhe mbaron në fund të qershorit. Gjatë takimit me sekretarinë mësimore u vunë re që ishin dhënë provime nga studentët jashtë sezoneve gjë që është në kundërshtim me strukturën mësimore të aprovuar. Kjo gjë u vu re nga datat e procesverbaleve që na u treguan nga ana e sekretarisë mësimore.

Kritere dhe procedure të vlerësimit

Kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve. Në Rregulloren e hartuar për këtë PS jepen gjithashtu format e Vlersimit (Kreu III i Rregullores)

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet: (Anekse, Tabela
 - Leksione 440 orë
 - Seminare/ushtrime 160 orë
 - Praktikë profesionale 75 orë
 - Temë diplome 125 orë

Nuk evidentohen orë të vecanta për laboratorët sipas lëndëve. Të gjithë sylabuset përdorin të njëjtin standart, ky zë nuk figuron, por është përfshirë në zërin seminare.

- Format e kontrollit të njohurive

Vlerësimi në një modul/lëndë bëhet bazuar në planin mësimor për këtë MP. Të gjitha modulet kanë të njëjtat zëra për vlerësim si detyra/projekte kursi, provim përfundimtar dhe punë në klasë. Provimet zhvillohen me shkrim ose me gojë.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Nga takimet e realizura në institucion nga ana jonë dhe bazuar në RVB, u vu re se nuk ka aktivizim të studentëve në kërkimet shkencore dhe projektet e implementuara nga departamenti, duke patur në konsideratë edhe kohën e shkurtër të aktivizimit të programit.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi dhe regjistrimi i aplikantëve në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit", realizohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, Udhëzimin Nr. 18, datë 17.08.2017 të MASR. Gjithashtu, institucioni ka hartuar një Rregullore për këtë PS, i cili ka përcaktuar procedurat dhe kriteret e pranimit (Kreu V i Rregullores).

GVJ mendon, se duhet të kihet kujdes në pranimin e studentëve që nuk kanë formim IT për arsye se mund të mos jenë në gjendje të ndjekin këtë program për mungesë të njohurive mbi teknologjinë e informacionit. Gjithashtu për studentët që nuk kanë formim IT të vendosen disa kriteret bazike parakualifikuese. Për studentët që pranohen jashtë profilit të programit, GVJ ju komunikua se për këta studentët, në bazë të aftësive dhe kompetencave të gjithësecilit, mund të ofrohen leksione shtesë në fushën e IT.

GVJ i qëndron mendimit se panvarësisht nga orët e leksioneve që mund të ofrohen shtesë, studentët jashtë fushës së IT, duhet ti nënshtrohen parakushteve, pasi egziston rreziku i uljes së nivelit akademiko-profesional për të plotësuar mungesën e formimit të fushës.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Për tu regjistruar në këtë program studimi, aplikantët duhet të dorëzojnë dosjet personale ku të kenë shprehur qartë edhe qëllimin e ndjekjes së studimeve në programin Master Profesional "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit" dhe nëse numri i aplikantëve është më i madh sesa kuatat e miratuara, atëherë përzgjedhja e tyre bëhet mbi bazën e intrvimit të tyre bazuar në parimet e barazisë, drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës. Kriteret e pranimit janë shprehur dhe në Rregulloren e këtij PS.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Aplikantët duhet të arrijnë rezultate të mira në çdo testim pranimi apo intervistë të kërkuar nga departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompiuterike.

Aplikantët duhet detyrimisht të zotërojnë një diplomë universitare "Bachelor" ose diplomë tjetër studimi të fituar brenda apo jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të në fushën përkatëse ose në fusha që lidhen me programin. Në rastin kur diploma nuk përputhet me fushën e programit të kërkuar,

Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompiuterike vlerëson nëse kualifikimet dhe përvoja në fushë janë të mjaftueshme apo përcakton nëse kandidati duhet të realizojë një program përafrimi.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Anekse, Tabela 16)

Programi i studimit Master në "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit" është hapur për herë të parë në vitin akademik 2018-2019.

Numri i studentëve të rregjistruar në këtë vit akademik është 10 studentë. Nota mesatare e studentëve të rregjistruar është 6,5.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Vlerësimi i studentëve është në proces dhe deri në momentin aktual nota mesatare 8,8.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Nuk ka mobilitet deri tani.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Duke qenë viti i parë i organizimit të programit të studimit Master Profesional në "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit", nuk mund të japim opinionin tonë për këtë tregues, pasi janë akoma në proces.

Numri total të diplomuarve

Studentët janë në vitin a parë dhe akoma nuk ishin të diplomuar kur GVJ kreu vizitën në Institucion.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Duke qenë viti i parë i organizimit të programit të studimit Master Profesional në "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit", nuk mund të japim opinion në lidhje me punësimin e studentëve mbas përfundimit të studimeve në këtë program studimor.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS; Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi; Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimi të përcaktuara nga institucioni; Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;	Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor". Në kriteret e pranimi pranohen edhe student me profil jo IT. Për tu rregjistruar në këtë program studimi, aplikantët duhet të dorëzojnë dosjet personale ku të kenë shprehur qartë edhe qëllimin e ndjekjes së studimeve në programin Master Profesional "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit" dhe nëse numri i aplikantëve është më i madh sesa kuotat e miratuara, atëherë përzgjedhja e tyre bëhet mbi bazën e intervistimit të tyre bazuar në parimet e barazisë, drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës. Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.

<p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.</p>	<p>Ky është Program i ri dhe ka vetëm një vit që është aktivizuar, megjithatë gjatë vizitës në institucion u konstatua se institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programet e studimit në përgjithësi.</p>
---	--

Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.

<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve; Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion; Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Sipas RVB, SHLUJ UMB ka dy zyra që japin informacion për mundësitë e punësimit dhe ofrojnë shërbimin e këshillimit. Zyra e Alumni dhe i Karrierës siguron një pikë fokusimi për studentët, komunitetin e gjerë universitar dhe botën e punës. Ajo mbështet në mënyrë aktive të diplomuarit në planet e tyre për karrierën dhe përshtatjen me tregun e punës.</p> <p>Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, i informon studentët për akreditimin e institucionit dhe gjithashtu ju ofron shërbim këshillimi për karrierën.</p> <p>Në gjykimin tonë nga strukturat e mësipërme Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës dhe u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit.</p>
---	--

Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar; Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik; Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni ka statistika per numrin e të diplomuarve për programe të tjera studimi, por jo për këtë PS, meqë ky është brezi i parë i studentëve që diplomohen.</p> <p>Institucioni ka statistika për numrin e studentëve të regjistruara në degët dhe nivele të ndryshme.</p> <p>Po ashtu, disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve, kryesisht nëpërmjet regjistrit të notave dhe procesverbaleve të dhënies së provimeve.</p>
---	--

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre; Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Ky është një master i ri dhe institucioni nuk ka ende një bazë të dhënash për studentët e punësuar pas përfundimit të PS.</p>
--	--

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit; Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p>	<p>Sekretaria mësimore dhe personeli akademik informon në mënyrë të vazhdueshme studentët për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit.</p>
--	---

<p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët përpara se të futen në provimin përfundimtar njoftohen me të gjitha pikët e mara sipas syllabusit. Nga takimi me studentët, GVJ konstatoi se studentët kishin mundësitë të komunikonin me përgjegjësin e modulit për cdo paqartësi apo ankesë që mund të kishin në lidhje me provimin.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e këshillimit të karrierës iu ofron shërbimin e këshillimit studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon në trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave që lidhen me procesin mësimor.</p> <p>Duke qënë një program i ri masteri, akoma nuk është krijuar mundësia e këshillimit nga ana e Zyrës së karrierës.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>1. Pranimi në programin e studimit bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. Institucioni përcakton kriteret të përgjithshme dhe specifike për pranimin e studentëve në programin e studimit Master profesional sipas rregullave në fuqi. Në këtë program janë rregjistruar edhe studentë me diplomë bachelor nga fakultete të tjera, dhe që nuk kanë formim IT. GVJ ju komunikua se për këta studentë, nëse vërëhen se kanë nevojë për njohuri shtesë, ofrohen leksione sipas kompetencave dhe aftësive të secilit kandidat. GVJ i qëndron mendimit se panvarësisht nga orët e leksioneve që mund të ofrohen shtesë, studentët jashtë fushë së IT, duhet ti nënshtrohen parakushteve, pasi egziston rreziku i uljes së nivelit akademiko-profesional për të plotësuar mungesën e formimit të fushës.</p> <p>2. Institucioni i informonte studentët në lidhje me programin e studimit që ofron dhe me politika e punësimit të studentëve.</p> <p>3. Institucioni disponon statistika për numrin e studentëve që ndjekin këtë PS, edhe pse numri i tyre aktualisht është shumë i vogël.</p> <p>4. Studentëve iu ofrohet shërbimi i Këshillimit të Karrierës. Institucioni disponon të dhëna të ndjekjes në mënyrë të vazhdueshme të çdo studenti gjatë zhvillimit të programit mësimor. Të dhënat ruhen në rregjistra.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Institucioni nëpërmjet strukturave të brendshme ka hartuar politika për kërkimin shkencor, të cilat ndihmojnë këtë PS. Në funksion të këtyre politikave janë botimet e realizuara ndër vite nga ana e stafit akademik, pjesëmarrjet e tyre në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore brenda dhe jashtë vendit. Nuk ka informacione për aktivitetet të vecanta të organizuara nga njësia për këtë PS, i cili sapo ka filluar aktivitetin e tij.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor

Në UMB funksionon Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti" (BIRD), Instituti Shqiptar për Çështje Publike (AIPA) dhe Instituti i Edukimit Barleti (IEB).

Sipas RVB *Institutet synojnë të realizojnë qëllimin e tij nëpërmjet kryerjes së punës studimore e kërkimore, trajnimeve, kurseve e konsultave, shërbimeve, veprimtarisë botuese dhe realizimit të projekteve të nivelit të lartë në të mirë dhe interes të publikut. UMB ka krijuar hap pas hapi të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të nxitur dhe mbështetur veprimtarinë kërkimore - shkencore ndërdisiplinore cilësore të strukturave të UMB-së, Instituteve. SHLUJ UMB, AIPA, BIRD dhe IEB, synojnë të bashkëpunojnë me institucione të tjera kërkimore-shkencore si dhe agjencitë e zhvillimit në rajon e më gjerë për organizimin e veprimtarive të përbashkëta si dhe të bëhen pjesëmarrës aktiv në rrjetet ndërkombëtare të institucioneve të kërkimit dhe zhvillimit. Institutet janë ngritur posaçërisht për t'i shërbyer qëllimit kryesor të kërkimit, duke u bërë krahu kryesor i SHLUJ UMB në këtë drejtim. Institutet janë njësi të angazhuara tërësisht në kërkimin që fokusohet jo vetëm në organizimin e mirë dhe rritjen e kapaciteteve të universitetit, por edhe në krijimin e një mjedisi të angazhuar në kërkim brenda tyre, që mbështet përpjekjet kërkimore dhe gjenerimin e një tërësie rrethanash të volitshme për kërkimin në kontekstin e gjerë socio-ekonomik të Shqipërisë. Ato përpiqen që të ruajnë balancën në zhvillimin e trinomit arsim - kërkim - inovacion, në përputhje me kriteret dhe standartet e BE-së.*

Për kërkimin shkencor u diskutua me GVJ edhe gjatë vizitës si me Përgjegjësen e Departamentit, me stafin akademik, ashtu edhe me Përfaqësuesin e Zyrës së Masterave. Kërkimi shkencor realizohet në nivel Institucional, Por GVJ është e fokusuar vetëm në këtë program që po vlerëson. Ashtu siç edhe e kemi shprehur më sipër, për këtë program studimi akoma nuk ka një aktivitet të tillë pasi është në vitin e parë të tij akademik.

- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL – **46** (Sipas RVB)
- Numri i projekteve kërkimore të fituara – **11**
- Numri i projekteve të zbatuara – **11**
- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL – **25** (Sipas RVB)
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL – **Të gjithë studentë dhe pedagogët e këtij programi** (Sipas RVB)
- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor – **nuk ka**
- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor – **nuk ka**
- Numri i Çmimeve Kombëtare – **2**

Niveli i botimeve është i kënaqshëm dhe i bollshëm. Gjithashtu përfshirja e stafit në projekte të ndryshme është e evidentueshme. Sugjerojmë që të ketë sa më shumë angazhim edhe nga ana e studentëve të këtij PS dhe përfshirjen e tyre në bashkëpunim me pedagogët apo udhëheqësit e tyre në vazhdim.

Të dhënat e mësipërme janë edhe në Anekse, tabela 17

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
--------------------	-----------------------------

Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.

Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;

Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe nga vizitat në institucion e GVJ në institucion, u konstatua se personeli akademik i programit të masterit profesional në “Menaxhim i teknologjisë së Informacionit” publikon artikuj dhe materiale shkencore në revista të ndryshme dhe merr pjesë në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore.

Nëpërmjet angazhimit në veprimtari shkencore, personeli akademik jep kontributin e tij shkencor në fushën e IT.

Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.

Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;

Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.

Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master Profesionel zhvillon procesin mësimor në gjuhën shqipe.

Departamenti nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj.

Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;

Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.

Institucioni angazhohet në kualifikimin e profesional të personelit akademik nëpërmjet organizimit të konferencave, seminareve, etj.

Stafi akademik ka qenë pjesë dhe ka përfutur nga pjesëmarrja në trajnime të organizuara në kuadrin e projekteve të ndryshme të zbatuara nga ShLUJ UMB, si psh, Projekti Tempus që trajnoi stafin akademik mbi të drejtat e njeriut dhe integrimin e të drejtave në arsimin e lartë, si edhe Projekti QAINAL, i cili ka në fokus përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie.

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

UMB disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik, të angazhuar në këtë program, e hartuar në bazë të deklarimeve personale dhe CV te tyre.

UMB disponon një bazë të dhënash lidhur me kualifikimin shkencor të stafit akademik, të përfshira në dosjet e personelit.

UMB disponon të dhëna për projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilat merr pjesë personeli akademik i këtij masteri profesional. Një pjesë e kësaj pune realizohet edhe nga institutet që janë pjesë e institucionit.

Bëhet fjalë për të dhëna të cilat nuk janë të organizuara në një database specifike, nga e cila mund të bëhen analiza po të nxirren konkluzione.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara brenda dhe jashtë vendit.
2. UMB mundëson kualifikimin shkencor të personelit akademik nëpërmjet organizimit të konferencave shkencore dhe botimeve.
3. UMB disponon të dhëna lidhur me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik, të paraqitura në dosjet personale të tyre. Nuk evidentohet ndonjë databaze specifike.


11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Sipas institucionit, SHLUJ UMB ka përcaktuar një politikë bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në dobi të përbushjes së objektivave të programeve që ofron. SHLUJ UMB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione. Edhe pse kemi marrëveshje bashkëpunimi me mjaft institucione të huaja, institucioni ka zgjedhur të zhvillojë mësimin vetëm në gjuhën shqipe. Institucionet e bashkëpunimit janë si më poshtë:

- Universiteti "Universum", Kosovë, 15.04.2007
- Universiteti për Biznes dhe Teknologji, Prishtinë, Kosovë, 07.03.2008
- Universiteti Shtetëror i Tetovës, Maqedoni, 07.03.2008
- Universiteti "Fama", Kosovë, 12.01.2009
- Universiteti Clemson, South Caroline, USA, dhe një sërë partnerësh ndërkombëtare, 8 Mars 2010 rinovuar në Janar 2017
- Universiteti i Udine-s, Fakulteti i Ekonomisë, Itali, 22.06.2010
- Universita Degli Studi di Genova, Italia 13.01.2015
- Universita Degli Studi Roma Tre, Italia 18.09.2014
- Instituti Teknologjik i Epirit 10.05.2014
- Lappeenranta University of Technology, Finland 01.08.2013
- Universita Degli Studi Roma Tre, Italia 26.06.2013
- University of Arkansas Clinton School 03.04.2013
- University of Studies of Bari, Italy 31.03.2013
- Il Politecnico di Bari (POLIBA), Italia 31.01.2013
- Istituto Nazionale di Architettura, Roma, Italia 31.07.2012
- AHLEI (American Hotel & Lodging Educational Institution) 27.02.2012
- Istituto Nazionale di Architettura INARCH, Lazio, Italia 17.02.2012



- Pearson Language Tests, London, United Kingdom 25.01.2012
- Seconda Universita Degli Studi di Napoli, Italia 11.07.2011
- Boumville College, Birmingham United Kingdom 22.06.2011

MARRËVESHJE ME SHKOLLA DHE INSTITUCIONE SHQIPTARE

- Ministri për Çështjet Vendore 21.06.2014
- Veneto Banka Tiranë 30.04.2014
- Komiteti Shqiptar i Helsinki! 31.03.2014
- Ministria e Kulturës 27.03.2014
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike 19.03.2014
- Njësia Bashkiake nr I 05.03.2014
- Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit 04.03.2014
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë 03.07.2013
- Shega Trans 30.06.2013
- Marketing and Distribution Albania 30.06.2013
- Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqsorë 04.06.2013
- Avokati i Popullit 29.04.2013
- Qendra për Nisma Ligjore Qytetare 07.04.2013
- Linja e Këshillimit për Gra e Vajza 07.04.2013
- Aleanca Gjimore për Zhvillim 07.04.2013
- USAID/Rritje Albania 17.03.2013
- Unioni i Gjyqtarëve 31.10.2012
- Agjencia e Shërbimeve të Sporteve 15.02.2012
- Shkolla "Internacional," Vlorë 27.10.2011
- Gjimnazi "Nënshkruesi i Pavarësisë Nebi Sefa" 12.05.2011
- Gjimnazi "Dituria", Lushnje 12.05.2011
- Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës 03.06.2010
- Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike 07.01.2010
- Universiteti Bujqësor i Tiranës 25.11.2008
- Ministria PÇS, Shërbimi Kombëtar i Punësimit 19.12.2007
- Ministria e Brendshme, Dept. i Administratës Publike 12.12.2007
- Zyra e Avokatisë Kalo & Associates 20.03.2007
- Studio Ligjore Hakani & Associates 16.03.2007
- Instituti i Studimeve Publike dhe Ligjore 14.03.2007

Marrëveshje me universitetet e rajonit

- Memorandum bashkëpunimi me universitetin AAB Prishtinë
- Memorandum bashkëpunimi me universitetin Shtetëror të Tetovës

- Universitetin për Biznes dhe Teknologji të Prishtinës (UBT)
- Memorandum bashkëpunimi me universitetin Dardania Prishtinë.

Këto marrëveshje janë shumë të rëndësishme për institucionin në mënyrë që të shkëmbehen dhe të implementohen përvojat më të mira. Numri i marrëveshjeve është i kënaqshëm dhe evidenton se institucioni ka punuar mjaft në këtë drejtim.

Këto marrëveshje efektojnë pozitivisht në përgjithësi në nivel institucioni dhe indirekt dhe këtë program studimi edhe pse marrëveshjet janë në kuadrin institucional dhe jo posacërisht për këtë PS.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Aktualisht UMB ka një numër të madh marrëveshjesh bashkëpunimi. Këto marrëveshje janë midis institucioneve publike dhe private, vendase dhe të huaja. Në kuadrin e këtij MP nuk vërehen marrëveshje të vecanta për këtë master, po për të gjitha PS-të e këtij Departamenti</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Institucioni garanton marrëdhëniet e frytshme të bashkëpunimit mes personelit të tij.</p> <p>Personeli i ka të qarta detyrat e caktuara dhe i nënshtrohet analizës së vazhdueshme të punës së tyre nga ana e strukturave perkatëse.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Aktualisht UMB ka Marrëveshje bashkëpunimi me Universitete vendase dhe të huaja. Këto marrëveshje nuk janë të fokusuar në këtë PS.</p> <p>Këto marrëveshje bashkëpunimi synojnë në kryerjen dhe mbikëqyrjen profesionale në përgjithësi. Nuk evidentohen marrëdhënie apo bashkëpunime të vecanta të mbikëqyrjes së praktikës nga ana e atyre institucioneve me të cilat ka marrëveshje.</p> <p>Nga RVB dhe nga vizita në UMB nuk konstatuam që të organizohen trajnime të mëtejshme profesionale me studentët e këtij PS.</p>

Në sygjerojmë që në bashkëpunim me biznesin, studentet të mund të bëjnë një praktike më afër realitetit.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Nga takimi i organizuar me stafin me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme u konstatua se klima e punës në UMB ishte bashkëpunuese dhe mbështetëse.
2. Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendit.
3. UMB ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh brenda dhe jashtë vendit. Gjithësesi ky PS përfiton në mënyre indirekte nga këto marrëveshje për të plotësuar këtë kriter.
4. Në kuadrin e këtij MP nuk vërehen marrëveshje të veçanta për këtë master, po për të gjitha PS-të e këtij Departamenti
5. Në sygjerojmë që në bashkëpunim me biznesin, studentet të mund të bëjnë një praktike më afër realitetit.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës **SWOT** (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

a. Pika të forta:

- 1) Programi ofrohet në përputhshmëri me strategjinë e Institucionit për ofrimin e profesionistëve të TI, Rregulloren e programit dhe me bazën ligjore aktuale.
- 2) Stafi akademik gëzon titujt dhe gradat e mjaftueshme për përballimin e këtij PS.
- 3) Kurrikula e ofruar është bashkëkohore dhe në përputhje me nevojat e tregut actual.
- 4) Infrastruktura e ofruar është e kënaqëshme dhe e mjaftueshme për zhvillimin normal dhe realizimin e orëve të mësimin

b. Pika të dobëta:

- 1) Mungesa e marrëveshjeve bashkëpunimi posaçërisht për këtë PS, me qëllim mbështetjen e aktiviteteve të ndryshme të procesit mësimor, duke përfshirë dhe praktikat profesionale
- 2) Bibliotekat në të dy kampuset e Institucionit kanë mungesa fizike në libra të lidhur me degën e informatikës, fondi i librave dhe i titujve ishte fare i vogël dhe jo i përditësuar me botimet e viteve të fundit. Duhet riparë buxheti në lidhje me shtimin e zërave të rinj.
- 3) Mos pasqyrimi në sylabuse siç duhet i orëve dhe detyrave laboratorike.

c. Mundësitë:

- 1) Përmirësimi në të ardhmen i Planit Mësimor, me lënde/module të propozuara nga ekspertët.
- 2) Shtimi i fondit të librave, revistave dhe botimeve të tjera për këtë PS.
- 3) Vendosja e kriterëve shtesë të pranimit për studentët e rinj jashtë profilit të TI.

d. Pengesat:

GVJ nuk evidentoi pengesa të veçanta apo të qënësishme për këtë PS i cili akoma nuk ka diplomuar studentët e parë të tij.

Rekomandime:

- 1) Programi mund të rishikohet në disa aspekte në të ardhmen, kryesisht në ofrimin e lëndëve me profesionale që lidhen me një master profesional në menaxhimin e IT dhe në shtimin e orëve laboratorike në disa module.
- 2) Të merren masa për shtimin e e titujve fizike ose i bibliotekës dixhitale.
- 3) Mund të shtohen/përditësohen kriteret e pranimi për studentët jashtë profilit.
- 4) Të shihet mundësi e lidhjes së marrëveshjeve të bashkepunimit specifike për këtë program studimi, për realizimin sa më të mirë të orëve mësimore dhe praktikave profesionale.
- 5) Rekomandohet që Institucioni të shikojë mundësinë e hartimit të një Plani Strategjik të Zhvillimit ku të shpjegohet në mënyrë të detajuar procesi i zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimeve si dhe të rezultateve të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

SUMMARY ANALYSIS FOR THE IMPLEMENTATION OF THE STUDY PROGRAM

Summary Analysis of the RVJ according to the SWOT method (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats)

a. Strengths Points:

- 1) The program is offered in accordance with the institution's strategy for providing IT professionals, the Program Regulation and the current Legal Framework.
- 2) Academic staff had the necessary titles and grades to handle this Study Program.
- 3) The curriculum in line with the market needs.
- 4) The infrastructure provided is satisfactory and sufficient for the normal development and realization of classes.

b. Weaknesses Points:

- 1) Lack of cooperation agreements specifically related to this Study Program, in order to support various learning process activities, including professional practices.
- 2) Libraries on both campuses of the Institution have physical deficiencies in books related to computing, the numbers of the books and titles fund were not enough and the publication years were not recent. The Institute should consider increasing the budget for the library.
- 3) Syllabus of laboratory hours and tasks are not properly reflected.

c. Opportunities:

- 1) Improving the study program with courses / modules proposed by the experts.
- 2) Increasing the fund of books, magazines and other publications for this Study Program.
- 3) Establishing additional admission criteria for new students out of IT profile.

d. Threats:

The GVJ did not identified any particular or significant obstacles to this Study Program that has not graduated its first students.

Recommendations:

- 1) The program may be revised in some aspects in the future, with the aim to offer more professional subjects related to a professional master in IT Management and some more laboratory hours in some modules.
- 2) Should be taken measures for adding other titles in the library / digital librari.
- 3) Additional admission criteria for out-of-profile students may be added / modified.
- 4) Should be consider the possibility of concluding specific cooperation agreements for this study program, in order to improve the teaching hours and professional practices.
- 5) It is recommended the development of the Strategic Development Plan explaining in details the process of developing and improving the study programs as well as teaching and learning outcomes.

External Evaluation Group

Prof. Dr. Kozeta Sevrani

Dr. Gjergji Mulla



ANEKS

Tabela 1 - Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat,

	Departamenti i Ekonomisë dhe Financës					
	Numri i PAE		Numri i PAK		Në total	
	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada
	3	Prof. Dr.	-	Prof. Dr.	3	Prof. dr
1	Prof. Asoc	-	Prof. Asoc	0	Prof. Asoc	
3	Dr.	4	Dr.	7	Dr.	
1	Msc.	3	Msc.	4	Msc.	
Fakulteti i Shkencave të Aplikuar dhe Ekonomisë	Departamenti i Biznes, Menaxhim, Turizëm					
	-	Prof. Dr.	1	Prof. Dr.	1	Prof. dr
	2	Prof. Asoc	-	Prof. Asoc	2	Prof. Asoc
	5	Dr.	2	Dr.	7	Dr.
	-	Msc.	2	Msc.	2	Msc.
	Departamenti i Arkitektures dhe Shkencave kompjuterike					
	1	Prof. Dr.	-	Prof. Dr.	1	Prof. Dr.
	1	Prof. Asoc	1	Prof. Asoc	2	Prof. Asoc
	5	Dr.	4	Dr.	9	Dr.
	8	Msc.	9	Msc.	17	Msc.

Tabela 2 - Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në Departamente

Departamenti i Arkitektures dhe Shkencave Kompjuterike							
Personeli Akademik Efektiv	Detyra në Dep.	Titulli/Grada	Personeli Akademik me Kontratë	Titulli/Grada	Institucioni ku punon full time		
1	Silvana Sukaj	Përgjegjës i dep.	Dr.	1	Parashevi Tashi	MSc	Arkitekt
2	Spartak Bagllamaja	anëtar	Ing/Ark. Msc	2	Elton Hala	Msc	Pedagog, arkitekt
3	Marenglen Spiro	anëtar	Prof. Dr.	3	Ani Cuedari	MSc.	Arkitekt
4	Arbana Kadriu	anëtare	Prof. As. Dr.	4	Nevila Malaj	MSc.	Arkitekt
5	Luan Bekteshi	anëtar	Dr.	5	Edlira Çoku	Msc.	Arkitekt
6	Eranda Shalsi	anëtare	Dr.	6	Jonida Mëniku	Dr.	Arkitekthe, pedagoge

7	Oltjon Luga	anëtar	Msc.	7	Gjergji Thomai	Dr.	Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit – AQTN
8	Anjeza Llubani	anëtare	Msc.	8	Ersilio Tushaj	MSc.	Bashkia Himare
9	Andi Gjokutaj	anëtar	Msc.	9	Marjo Hysenlliu	MSc.	Instituti i ndërtimit- laborant
10	Migena Buzra	anëtare	Msc.	10	Iva mezezi	MSc	Arkitekt
11	Esmeralda Kazia	anëtare	Msc.	11	Armond Kurti	MSc	Arkitekt
12	Ajda Çarçani	anëtare	Msc.	12	Enio Deneko	Dr.	Pedagog, arkitekt
13	Jonila Prifti	anëtare	Dr.	13	Blerta Dymishi	MSc	Pedagoge
				14	Igli Tafaj	Prof. As. Dr.	Pedagog UT
				15	Skender Minarolli	MSc.	IT
				16	Akil Ndrenika	Msc.	BKT
				17	Nora Ajazi	Msc	IKMT, Arkitekthe
Departamenti i Ekonomise dhe Finances							
Personeli Akademik Efektiv		Detyra në Dep.	Titulli/Grada	Personeli Akademik me Kontratë		Titulli/Grada	Institucioni ku punon full time
1	Suzana Guxholli	Përgjegjës i dep.	Prof. Dr.	1	Albana Gjoni	Dr.	UBT
2	Jorgji Bollano	anëtar	Prof. Dr.	2	Lirola Kerri	Dr.	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
3	Nevruz Koçi	anëtar	Prof. Dr.	3	Denisa Salillari	Dr.	Pedagoge
4	Altin Muça	anëtar	Prof. As. Dr.	4	Majlinda Maqellari	Dr.	Eksperte kontabël dhe lektore
5	Elira Hoxha	anëtare	Dr.	5	Sokol Lula	Msc.	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
6	Teuta Çerpja	anëtare	Dr.	6	Doris Muça	Msc.	Pedagoge
7	Eugen Musta	anëtar	Dr.	7	Neritan Totozani	Msc.	Min.Financës
8	Brikena Tolli	anëtare	MSc				
Departamenti i Biznes, Menaxhim, Turizëm							
Personeli Akademik Efektiv		Detyra në Dep.	Titulli/Grada	Personeli Akademik me Kontratë		Titulli/Grada	Institucioni ku punon full time
1	Bashkim Berberi	Përgjegjës i dep.	Dr.	1	Lavdrim Sahitaj	Dr.	Drejtoria e Thesarit
2	Semiha Loca	Anëtar	Prof. As. Dr.	2	Bardhyl Çeku	Prof.dr.	UBT

Handwritten signature

Handwritten signature

3	Shpetim Cami	Anetar	Prof. As. Dr.	3	Forcim Kola	Dr.	FZH
4	Gazmend Zeneli	Përgjegjës i dep.	Dr.	4	Nevila Popa	MSc	H.Rogner
5	Teuta Nunaj	anëtar	Dr.	5	Violdi Danaj	MSc	Agna Group
6	Jonida Këllezi Çako	anëtare	Dr.				
7	Kejda Nuhu	anëtare	Dr.				

Tabela 3 – Staf i akademik i angazhuar në këtë program studimi

Stafi akademik për programin e studimit Master Profesional "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit", për vitin akademik 2018 - 2019							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time		
1 Arbana Kadriu	Pedagoge	Prof. Asoc.	1 Igli Tafaj	Prof. Asoc.	Universiteti i Tiranës		
2 Luan Bekteshi	Pedagog	Dr.					
3 Esmeralda Kazia	Pedagoge	MSc. (doktorante)					
4 Gazmend Zeneli	Pedagog (departamenti Biznes, Menaxhim dhe Turizëm)	Dr.					
5 Kejda Nuhu	Pedagoge (departamenti Biznes, Menaxhim dhe Turizëm)	Dr.					

Tabela 4 - Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (plotëso Tabelën 5)

Titulli	Stafi akademik për programin e studimit Master Profesional "Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit" Viti akademik 2018-2019		
	PAE	PAK	PAE/PAK
Profesorë	-	-	-
Profesorë të As.	1	1	1/1
DR/PhD	3	-	-
Pedagogë në proces Dr	1	-	-

Signature

Signature

Asistentë me Msc	-	-	-
Personeli Nd akademik	-	-	-

Tabela 5 - Të dhëna sipas moshës

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAE dhe PA me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë					
Profesorë të As.		1			
DR/PhD		1	2		
Pedagogë në proces Dr	1				
Asistentë me Msc					
Personeli Ndhimes akademik					
Totali					

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAK me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë të As.		1			
DR/PhD					
Pedagogë në proces Dr					
Asistentë me Msc					
Personeli Ndhimes akademik					
Totali					

Tabela 6 - Këshilli Shkencor i Programit të studimit/Koordinatori i programit të studimit

Emër Mbiemër	Titulli/grada	Pozicioni në Këshillin shkencor
Arbana Kadriu	Prof. Asoc. Dr.	Kryetar
Luan Bekteshi	Dr.	Anëtar
Esmeralda Kazia	Drnt.	Anëtare

Tabela 7 - Mjediset e fakultetit

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia	Sipërfaqja

le Seay

Salla për leksione	34	1802,8
Klasa për seminare		
Salla për aktivitete promovuese	6	1276,1
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	8	
Laboratorë për lëndët	5	217,5
Laboratorë informatike	7	278,5
Salla interneti (ëireless në të gjithë sipërfaqen, godinat)	1+2	5500
Salla për bibliotekë	2	80,66
Mjedis për fotokopjime, librari etj	2	40,2
Zyrë informacioni për studentët	6	106,97
Korridore/holle	2	354,1
Mjedise sportive	3	970,4
Mjedise shërbimi për të tretë	5	
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	1	13,5
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj	6	1864,5
Nyje hidrosanitare për studentët	49	196
Norma m²/për student	7 m² për student	

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	5	120,51
Zyra për sekretarinë mësimore	2	64,15
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	3	91,65
Zyra për personelin akademik	36	758
Zyrë për financën	4	70,65
Zyrë për Njësinë e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Sigurimin e Cilësisë	2	33,3
Salla për mbledhje	5	342,8
Mjedis për stafin e shërbimit	15	204,32
Norma m²/për person		

Tabela 8: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në programin e studimit (plotëso tabelën 8)

Të ardhurat nga:	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Pushteti qendror					
Pushteti vendor					
Fonde jopublike:					
Grantet për kërkim dhe kontratat					
Konsulentat, shërbimet	8.747.857	3.881.090	9.943.761	2.228.200	2,679,975
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	93.182.000	109.759.440	122.819.073	185.722.946	251,759,242
Sponsorizimet					
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	454.475	1.724.400	4.480.183	11.662.152	2,934,832
Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj					
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)					
Të tjera (qera, ndryshime kursi valutor, interesa bankare)	14.222	983.441	927.477	409.840	598,764
Gjithsej	102.398.554	116.348.371	138.170.494	200.023.138	257,972,813
SHUMA	102.398.554	116.348.371	138.170.494	200.023.138	257,972,813

Tabela 9 – Plani mësimor i programit

Nr	Emërtimi i lëndëve	Kodi	Semestri		Shpërndarja e ngarkesës mësimore				Kredite
			I	II	Orë leksione në auditor	Orë në auditor për aktivitete tjera (seminare)	Orë gjithsej për studim individual	Totali i orëve	
1	Sistemet e informacionit në organizata	SIO	+		30	20	75	125	5
2	Manaxhim i projekteve në fushën e TI	MPI	+		30	20	75	125	5
3	Metoda të Kërkimit Shkencor	MKS	+		30	20	75	125	5
4	Manaxhimi i proceseve të softuerit	MPS	+		30	20	75	125	5
5	Modelet e e-Biznesit	MEB	+		30	20	75	125	5
6	Sistemet e ndërmarrjeve dhe manaxhimi i zinxhirit të furnizimit	SZF	+		30	20	75	125	5
7	Data Warehousing	DË		+	30	20	75	125	5
8	Manaxhim rrjetash	MRR		+	30	20	75	125	5

Handwritten signature

Handwritten signature

9	Stazh ose praktikë profesionale	MP78		+	75		50	125	5
10	Prova finale (punim individual, mikrotezë)	MP98		+	125		250	375	15
TOTALI:					440	160	900	1500	60

Tabela 10: Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për:

- Leksionet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Seminaret/ushtime 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Praktikën Profesionale 75 orë në auditor dhe 50 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 125 orë në auditor dhe 250 orë punë e pavarur e studentit

Tabela 11: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)

PLANI MËSIMOR NË PROGRAMIN E STUDIMIT MASTER PROFESIONAL NË "MENAXHIM I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT"			
Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Lënda/Moduli	Kreditet	Totali
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)	Manaxhimi i Projekteve në fushën e TI	5	10
	Sistemet e Informacionit në Organizata	5	
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B)	Manaxhim Rrjetash	5	25
	Manaxhim i Proçeseve të Softuerit	5	
	Modelet e e-Biznesit	5	
	Data Warehousing	5	
	Kërkimi Shkencor	5	
Vepr. në disiplina të Ngjashme dhe/ose integrale (C)	Sistemet e Ndërmarrjeve dhe Manaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit	5	5
Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (D)	Praktikë Profesionale	5	5
Teza e Diplomës (E)	Prova Finale	15	15

Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licensuara
Nuk ka ndryshime në planin mësimor duke qenë se është viti i parë i sapolicensuar.

Tabela 12: Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës

Viti akademik 2018-2019.					
Lënda /Moduli	Pedagogu/Pedagogët	Titulli/grada	Departamenti	Statusi	Kredite
	përgjegjës	kualifikimi		PAE apo PAK	
1. Menaxhim i Projekteve në fushën e TI	Esmeralda Kazia	MSc. (Drnt)	ArkShkKompiut	PAE	5

Handwritten signature

Handwritten signature

2.	Sistemet e Informacionit në Organizata	Igli Tafaj	Prof. Asoc	ArkShkeKompiut	PAK	5
3.	Metodat e Kërkimit Shkencor	Gazmend Zeneli	Dr.	Biz, Men, Tur	PAE	5
4	Data Warehousing	Igli Tafaj	Prof. Asoc.		PAK	5
5	Manaxhim i Proçeseve të Softuerit	Arbana Kadriu	Prof. Asoc	ArkShkeKompiut	PAE	5
6	Manaxhim Rrjetash	Luan Bekteshi	Dr.	ArkShkeKompiut	PAE	5
7	Modelet e e-biznesit	Luan Bekteshi	Dr.	ArkShkeKompiut	PAE	5
8	Sistemet e Ndërmarrjeve dhe Manaxhimi i zinxhirit të Shpërndarjes	Kejda Nuhu	Dr.	Biz, Men, Tur	PAE	5
9	Stazh ose Praktikë Profesionale				PAE	5
10	Prova Finale (punim individual, mikrotezë)				PAE	15
Gjithsej: % PAE/PAK - 83.3/16.7					kredite	60

Tabela 13. Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies,

Programi i Studimit.....		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	440
b.	Seminare	160
c.	Ushtrime	
d.	Laboratore	
e.	Praktikë lëndore	-
f.	Praktikë profesionale	75
g.	Punim Diplome	125
	Në total	800

Tabela 14: Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	15 %

Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit). Testimet gjatë vitit.	35 %
Provimi përfundimtar	50 %
Në total	100 %

Tabela 15: Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	9
Për projekte shkencore në rang Departamenti	9
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	9
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	9

Tabela 16: Cilësia në hyrje e studentëve

Programi i studimit MP në "Menaxhim i Teknologjisë Informacionit"	Studentë të regjistruar në vitin akademik	Nota Mesatare	Studentë të regjistruar me transferim	Nota Mesatare (deri në këtë moment)	Totali i studentëve të regjistruar
2018-2019	10	6,5	0	8,8	10
Në total	10	6,5	0	8,8	10

Tabela 17: Të dhëna për kërkimin shkencor

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang Institucioni në vitet e fundit	
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL 46 artikuj 14 publikime në proceedings 2 monografi 2 libra dhe kapituj 2 tekste mësimore
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara 11
3.	Numri i projekteve të zbatuara 11
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL 25
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi janë përfshirë në aktivitete të ndryshme me karakter shkencor që janë zhvilluar në UMB
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi janë përfshirë në forma të ndryshme në kërkimin shkencor

7.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi janë përfshirë në forma të ndryshme në kërkimin shkencor
8.	Numri i Çmimeve Kombëtare	2 (Katedra Jean Monnet, Katedra UNESCO)

Le Seny



